

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve M.K dhe A.G, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë, nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A.G, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.2652/16 të datës 09.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.35/2018 të datës 29.06.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 4 dhjetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A.G, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.2652/16 të datës 09.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.35/2018 të datës 29.06.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PKR.nr.2652/16 e datës 09.10.2017, të dënuarit M.K dhe A.G, i ka shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e rëndë, nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka gjykuar secilin me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë secilin në shumë prej nga 2000 (njëmijë) €, në të cilin dënim u është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 18.11.2016 deri me datë 04.04.2017, masa e arrestit shtëpiak prej datës

04.04.2017 deri me datë 09.10.2017, si dhe masa e paraburgimi nga data 09.10.2017 e tutje. Në emër të paushallit gjyqësor janë obliguar që të paguajnë shumën prej 50€, kurse të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.35/2018 e datës 29.06.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.G, av. D.M, nga P, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën dhe aktgjykimet e kundërshtuara të i ndryshoj dhe të dënuarin ta shpall të pafajshëm.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.nr.203/2018 e datës 12.11.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, meqë me rastin e dëgjimit të dëshmitares Z.N, e njëjta është dëgjuar në cilësinë e të dëmtuarës edhe pse nuk ka qenë e dëmtuar pasi që edhe vet ka deklaruar se stolitë e arit kanë qenë të motrës së saj M.S, dhe kunatës së saj H.Rr.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar gabimisht kur ka refuzuar propozimin që të bëhet ekspertiza e re psikiatrike për të dënuarin tjetër M.K, pasi që i njëjti ka probleme

mendore të cilat kanë qenë evidente gjatë zhvillimit të procedurës penale. Ekspertiza e re do të ishte e rëndësishme për faktin se i dënuari A.G është shpallur fajtor dhe është dënuar vetëm duke u bazuar në deklarinimin e të dënuarit M.K. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë alibinë e të dënuarit se në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale i dënuari ka qenë duke punuar dhe për më tepër aspekti i alibisë nuk është arsyetuar në mënyrë të duhur.

Më tutje pretendohet se shkeljet e procedurës penale të gjykatës së shkallës së parë nuk janë evituar nga gjykata e shkallës së dytë, e cila nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore, mirëpo vetëm e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë pa dhënë arsyetim të duhur.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në shqyrtimin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë është e saktë se në cilësinë e dëshmitares- të dëmtuarës është dëgjuar Z.N, mirëpo kjo nuk paraqet shkelje siç pretendohet në kërkesë, meqë edhe sipas dëshmisë së saj, por edhe dispozitivit të aktgjyimit qartazi është theksuar se dëshmitarja ka pasur në ruajtje stolitë e arit në shtëpinë e saj edhe pse i takonin motrës së saj e cila gjendet në Gjermani. Përkundër kësaj është i pakontestueshëm fakti se ngjarja është zhvilluar në shtëpinë e të dëmtuarës Z.N, dhe sipas përshkrimit të dispozitivit të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë me këtë rast të dënuarit paraprakisht thyejnë dyert dhe demolojnë dhomat e fjetjes e që në këtë shtëpi banonte edhe e dëmtuara Z.N, e nga kjo del se e njëjta kishte edhe cilësinë e të dëmtuarës.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e saj ndaj të dënuarit A.G e bazon vetëm në mbrojtjen e të dënuarit M.K, pasi që me

këtë rast janë administruar edhe prova tjera siç është përshkruar në faqen e gjashtë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë edhe pse një pjesë e veprimeve të të dënuarit A.G mbështetet në mbrojtjen e të dënuarit tjetër M.K.

Përkitazi me alibinë e të dënuarit A.G, gjykata e shkallës së parë, në faqen e shtatë të aktgjykimit të saj ka dhënë arsye për faktin se pse nuk u ka besuar dëshmitarëve të propozuar Jetmir Gashi dhe Fatmir Kryeziu, përkitazi me alibinë e të dënuarit A.G, pasi që këto dëshmi kanë rënë në kundërshtim me mbrojtjen e tij të dhënë gjatë fazës hetimore, ku i dënuari kishte deklaruar se ishte duke punuar në një vend tjetër dhe jo në vendin ku pohonin dëshmitarët. Për më tepër, në arsyetim potencohet fakti se njëri ndër dëshmitarët e dëgjuar ishte vëllai i të dënuarit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj, në faqen e nëntë, ka dhënë arsye përkitazi me ekspertizën psikiatrike për gjendjen mendore të të dënuarit M.K, ashtu që me të pasur dyshime përkitazi me gjendjen mendore të të dënuarit, ka caktuar tre ekspertë të lemisë së psikiatrisë për të bërë ekzaminimin e të dënuarit e që ekspertët pas ekzaminimit klinik kanë përpiluar ekspertizën dhe njëri nga ta edhe ka dhënë sqarime shtesë gjatë shqyrtimit gjyqësor në të cilën është konstatuar se i dënuari nuk vuan nga çrregullimi i kualitetit psikotik, nuk ka prapambetje mendore, kurse gjatë kryerjes së veprës penale aftësia e të kuptuarit dhe kontrollit të veprimeve të tij ka qenë e ruajtur dhe kishte aftësi për konsultim me personat e tjerë dhe nuk janë gjetur elementet e natyrës psikike të cilat do të ndikonin në validitetin e deklarimeve të tij. Andaj bazuar në faktin se ekspertiza ka konstatuar gjendjen mendore të të dënuarit, me të drejtë gjykata e shkallës së parë i fal besimin kësaj ekspertize dhe nuk e sheh të nevojshme caktimin e ekspertizës së re përkatësisht refuzon propozimin e mbrojtësit të të dënuarit M.K.

Pretendimet përkitazi me faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore përkitazi me të dënuarin A.G, po ashtu nuk qëndrojnë dhe bazuar në arsyetimin e kësaj gjykate është dhënë arsyetim i qartë dhe i plotë për secilin pretendim ankimor, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës e pranon në tërësi arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë.

Përkitazi me pretendimet e theksuara për shkelje të ligjit penal edhe pse është cekuar si shkelje, megjithatë në kërkesë nuk është paraqitur asnjë pretendim konkret, andaj, kjo pikë e kërkesës nuk u trajtua, bazuar në nenin 436 par.1 të KPPK-së, sepse Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve në të cilat pretendon paraqitësi i kërkesës.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.289/2018, më 4 dhjetor 2018

Bashkëpunëtori profesional,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Nesrin Lushta